



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sport

Prishtinë, 13 mars 2023

THIRRJA PËR PROJEKT-PROPOZIMET NË FUSHËN E RINISË 2023 PËR OJQ DHE INDIVIDË

Zhvillimi i Rinisë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në fushën e rinisë për vitin 2023 rendit ndër prioritetet programore mbështetjen e projekteve që zhvillojnë kapacitetet dhe shkathtësitë e të rinjve përmes metodologjisë së edukimit joformal dhe aktiviteteve të tjera të dobishme për zhvillimin individual të të rinjve dhe rritjen e kontributit të tyre në shoqëri.

Prioritet tjetër për vitin 2023 është rritja e shkallës së integritit social dhe ekonomik të të rinjve në rrezik marginalizimi si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikente, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet joshumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.

Për herë të parë thirrja publike në fushën e rinisë e administruar nga MKRS hapë mundësinë e financimit të projekt-propozime të individëve dhe grupeve joformale të moshës rinore.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet në fushën e rinisë për vitin 2023 synon mbështetjen e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve që zhvillohen në Republikën e Kosovës apo në shtetet ku është e koncentruar diaspora, të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Përfshirja e të rinjve në edukim joformal dhe aktivitete të tjera të dobishme për zhvillimin individual dhe shoqëror;
- Ngritja e kapaciteteve dhe aktivizimi i mekanizmave përfaqësues në sektorin rinor dhe fuqizimi i tyre në vendimmarrje të nivelit lokal dhe qendror;

- Mbështetja direkte e ideve të të rinjve përmes projekteve që kanë një impakt pozitiv në shoqëri dhe komunitetet e tyre.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit rinor në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, vajzat, personat me aftësi të kufizuar, komunitetin LGBTQ+, komunitetet pakicë, të rinjtë e zonave rurale, etj.

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në këtë thirrje publike kanë OJQ-të dhe Individët që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i profilizuar në fushën përkatëse me fokus rininë. OJQ-të dhe Individët mund të aplikojnë në një të një nga kategoritë në vijim:

1. Kategoria e parë: Mbështetja për zhvillimin e të rinjve (OJQ)

- Organizatrat dhe institutet profesionale vendore që do zhvillojnë trajnime me të rinjtë dhe i certifikojnë ata në fusha dhe profesione specifike, me projekt-propozime të mëdha.
- Buxheti: 10,000.00 - 40,000.00 Euro

2. Kategoria e dytë: Mbështetja për zhvillimin e sektorit rinor (OJQ rinore)

- Organizatrat lokale rinore që udhëheqën dhe përbëhen nga të rinjtë, përfshirë Qendrat Rinore, me projekt-propozime të mesme.
- Buxheti: 5,000.00 - 10,000.00 Euro

3. Kategoria e tretë: Mbështetja për të rinjtë (individë)

- Të rinjtë individual dhe grupet joformale të përfaqësuara nga një individ, me projekt-propozime të vogla.
- Buxheti: 3,000.00 - 5,000.00 Euro

OJQ-të mund të aplikojnë **vetëm në një të një nga kategoritë 1 ose 2** të kësaj thirrjeje publike.

Individët mund të aplikojnë **vetëm në kategorinë 3** të kësaj thirrjeje publike.

Tre kategoritë e listuara më sipër janë elaboruar më poshtë, duke zbërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëvëprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, si dhe shkallën maksimale dhe minimale të mbështetjes.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, që vlerëson:

- Nëse aplikuesi është i profilizuar apo ka përvojë paraprake në fushën e rinisë apo edukim joformal (trajnime, seminare, etj.);
- Nëse projekt-propozimi targeton dhe shërben të rinjtë e moshave 15 vjeç deri 24 vjeç, në veçanti të rinjtë në rrezik marginalizimi si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikuentë, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet joshumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.
- Nëse aplikuesi ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e projekteve në vitet paraprake;
- Nëse aplikuesi ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

Aplikimi me projekt-propozime bëhet nëpërmjet formës online në uebfaqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

Link:

<https://mkrs.rks-gov.net/shq/for-the-public/announcement/grant-announcement/details/?grantAnnounce=22>

Afati për aplikim:

Afati i fundit për aplikim është 20 ditë pune dhe përfundon me datën:

07 prill 2023, në ora 16:00.

Më shumë informacione rreth thirrje publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: Imran.Rasimi@rks-gov.net jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

KATEGORIA E PARË:

Mbështetja për zhvillimin e të rinjve (OJQ)

Duke u ndërlidhur me Vitin Evropian të Aftësive 2023, synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është është që t'ju mundëson rinjve që të zhvillojnë kapacitetet dhe shkathtësitë e tyre përmes metodologjisë së edukimit joformal dhe aktiviteteve të tjera të dobishme për zhvillimin individual dhe shoqëror.

Kategoria e parë targeton organizatat jo-qeveritare me përvojë në fushën e edukimit joformal (trajtime, seminare, workshope, etj.), projekt-propozimet e të cilave do të targetojnë të rinjtë e moshave 15-24 vjeç. Në këtë kategori parashihet mbështetja e OJQ-ve me kapacitete profesionale dhe teknike në fushën që mbulon projekt-propozimi përkatës, të cilat janë të organizuara mirë, kanë vizion të qartë, kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit përkatës në Kosovë. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për implementimin e programeve për zhvillimin e shkathtësive e të rinjve synohet:

1. **Trajnimi dhe certifikimi i të rinjve përmes fushës së edukimit joformal duke avancuar aftësitë specifike tek të rinjtë si:**
 - 1.1. *Zhvillimi i aftësive në Sektorët e Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit (TIK) përfshirë kodimi, Microsoft 365, menaxhimi i rrjeteve sociale, etj.*
 - 1.2. *Industria kreative dhe/ose fushat e dizajnit (web dizajn, modë, dizajn interior, dizajn grafik, film dhe animacion), etj.*
 - 1.3. *Zhvillimi i aftësive në fushat STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë).*
 - 1.4. *Trajnimi në fushën e ndërmarrësisë përfshirë kontabilitetit, menaxhimit të projekteve, marketingut, etj.*

- 1.5. *Zhvillimi i aftësive të buta* si lidhshipi, komunikimi efektiv, mendimi kritik, negociimi, hulumtimi, ndërveprimi, etj. në sektorë të ndryshëm.
- 1.6. *Zhvillimi i aftësive në turizëm* përfshirë gastronomi, hotelieri, kuzhinë dhe pastičeri, etj.
- 1.7. Të tjera trajnime dhe certifikime *specifike* për të rinjtë.

Kush mund të aplikojë:

- Organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat janë të fokusuara në fushën e edukimit joformal dhe/ose në sektorin relevant për projekt-propozimin, me një eksperiencë të dëshmuar në punë me të rinjtë dhe që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara me këtë thirrje

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike të krijuara (mos të ketë avanse të hapura);

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e edukimit joformal dhe/ose sektorin përkatës që mbulon projekt-propozimi, me përvojë të dëshmuar në punën me të rinjtë;
- Pajisja e të rinjve me certifikata nga organizatat vendore për pjesëmarrje dhe përfundim të suksesshëm të programit në fushën e edukimit joformal;

- OJQ-të duhet të specifikojnë kualifikimin/certifikaten që do marrin të rinjtë pjesëmarrës dhe të cekin nëse certifikata njihet ndërkombëtarisht dhe është e akredituar;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e edukimit joformal në së paku 2 vitet e fundit;
- Të ofrojnë shumën mesatare të qarkullimit vjetor për vitet paraprake (2021-2022) e cila duhet të jetë së paku dyfishi i shumës së aplikimit në këtë thirrje publike.
- Të integrojnë, buxhetojnë dhe zbatojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm dhe Vlerësimit të ndikimit social dhe ekonomik të projektit të OJQ-së në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike;
- Të integrojnë komponentën e gjithëpërfshirjes dhe rritjes së shkallës së integritit social dhe ekonomik të të rinjve në rrezik marginalizimi si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikuentë, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet joshumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.;
- Të përdorin metodologjinë e edukimit joformal si trajnimet, konferencat, punëtoritë, seminarët, debatet dhe shkëmbimin e përvojave.

Vini re:

Nëse organizata është e kualifikuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, duhet të ofrohet dëshmia në projekt-propozim.

Nëse projekti përzgjedhet dhe financohet nga MKRS, për qëllime të monitorimit është i obligueshëm informimi i Departamentit të Rinisë mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit së paku dy javë para realizimit të aktivitetit.

Nëse projekti përzgjedhet dhe financohet nga MKRS, organizata dhe vullnetarët e organizatës në zbatimin e projektit në kuadër të kësaj thirrjeje të regjistronen në platformën për certifikimin e orëve vullnetare 'Kosovo Volunteers' apo KoVo.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit 40,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit 10,000.00 Euro

Vlera totale e planifikuar për këtë kategori është 250,000.00 Euro.

KATEGORIA E DYTË:

Mbështetja për zhvillimin e sektorit rinor (OJQ rinore)

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është aktivizimi, zhvillimi dhe mbështetja e sektorit rinor, organizatave rinore, qendrave rinore dhe mekanizmave tjerë përfaqësues rinor. Kjo kategori mbështet mekanizmat rinor në Kosovë të regjistruara si organiza jo-qeveritare të profilizuara në fushën e rinisë, duke financuar aktivitetet të cilët bazohen në përfaqësimin dhe mobilizimin e të rinjve dhe që promovojnë vlerat e qytetarisë aktive dhe aktivizmit rinor dhe që promovojnë çështjet e të rinjve dhe punën rinore. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për mekanizmat rinor, synohet:

1. Mbështetja e projekteve të organizuara dhe udhëhequra nga mekanizmat rinor, organizatat rinore (të udhëhequra dhe në përbërje nga të rinjtë) dhe organizatat rinore ombrellë.
2. Financimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve që organizohen në qendrat rinore të Republikës së Kosovës.
3. Financimi i aktiviteteve që angazhojnë vullnetarë dhe promovojnë vullnetarizmin te të rinjtë.
4. Mbështetja për projektet që ndërlidhen me së paku njërin prej Objektivave Evropiane për Rininë (Ang: European Youth Goals) të përcaktuara nga Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027:
 - 4.1. *Lidhja e rinisë me BE-në; Barazi për të gjitha gjinitë; Shoqëritë gjithëpërfshirëse; Informacion dhe dialog konstruktiv; Shëndeti dhe mirëqenia mendore; Përparimi i rinisë rurale; Punësimi cilësor për të gjithë; Arsimi cilësor; Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë; Evropa e gjelbër e qëndrueshme; Organizatat rinore dhe programet evropiane.*
 - 4.2. *Për më shumë, vizitoni faqen: https://www.oph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf*
5. Rritja e shkallës së integritimit e të rinjve në rrezik marginalizimi në sektorin rinor si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikuentë, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet joshumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.
6. Rritja e cilësisë së aktiviteteve dhe organizimeve rinore në Republikën e Kosovës;

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të profilizuara në sektorin rinor, me përvojë të dëshmuar në fushën e rinisë, **që udhëhiqen dhe përbëhen nga të rinjtë** dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Në rast që OJQ-ja ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike të krijuara (mos të ketë avanse të hapura).

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në sektorin e rinisë, të udhëhequra dhe përbëra nga të rinjtë (15-24 vjeç) e cila dëshmohet me hartimin e strukturës organizative udhëheqëse me emrat dhe datëlindjet e vendimmarrësve në organizatë. *Ky kriter nuk aplikohet për Qendrat Rinore të Kosovës.*
- Të ofrojnë portfolio me dëshmi të mbarëvajtjes së aktiviteteve në sektorin e rinisë së paku 2 vite me radhë;
- Të ofrohet pasqyra e ndikimit ekonomik dhe social gjatë viteve paraprahe. Raporti duhet të mbajë të paktën të dhëna rreth numrit të të rinjve pjesëmarrës, numrit të anëtarëve rinor në organizatë, numrit të vullnetarëve, etj. Inkurajohet ofrimi i dëshmive mbi ndikimin socio-ekonomik dhe vlerësimet mbi cilësinë e organizimeve/ngjarjeve gjatë viteve paraprahe;
- Të integrojnë komponentën e gjithëpërfshirës dhe rritjes së shkallës së integritimit social dhe ekonomik të të rinjve në rrezik marginalizimi si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikuentë, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet jo shumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.

Vini re:

Nëse projekti përzgjedhet dhe financohet nga MKRS, për qëllime të monitorimit është i obligueshëm informimi i Departamentit të Rinisë mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit së paku dy javë para realizimit të aktivitetit.

Nëse projekti për zgjedhet dhe financohet nga MKRS, organizata dhe vullnetarët e organizatës në zbatimin e projektit në kuadër të kësaj thirrjeje të regjistrohen në platformën për certifikimin e orëve vullnetare 'Kosovo Volunteers' apo KoVo.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit 5,000.00 Euro

Vlera totale e planifikuar për këtë kategori është 125,000.00 euro.

KATEGORIA E TRETË:

Mbështetja për të rinjtë (individë)

Ministria së Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon që për herë të parë t'i jap mundësi të rinjve individë dhe grupeve joformale të përbërë nga të rinjtë të aplikojnë për mbështetje financiare me projekt-propozime që adresojnë sfidat shoqërore duke synuar integrimin e të rinjve në politikat zhvillimore për një mirëqenie të avancuar sociale dhe ekonomike.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të individëve të rinj, aktiv në shoqëri, me ide të mira dhe pozitive për shoqërinë, përfshirë studentët, të sapo diplomuarit dhe profesionistët e rinj, me synim:

1. **Mbështetja direkte e ideve të të rinjve përmes projekteve që kanë një impakt pozitiv në shoqëri dhe komunitetet e tyre.**
 - 1.1. Mbështetje për projektet inovative që adresojnë sfidat në komunitetet e Republikës së Kosovës. Projektet duhet të ndërliken me së paku njërin nga 11 Objektivave Evropiane për Rininë (Ang: European Youth Goals) të përcaktuara nga Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027:
 - 1.2. *Lidhja e rinisë me BE-në; Barazi për të gjitha gjinitë; Shoqëritë gjithëpërfshirëse; Informacion dhe dialog konstruktiv; Shëndeti dhe mirëqenia mendore; Përparimi i rinisë*

rurale; Punësimi cilësor për të gjithë; Arsimi cilësor; Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë; Evropa e gjelbër e qëndrueshme; Organizatat rinore dhe programet evropiane;

- 1.3. Për më shumë, vizitoni faqen: https://www.oph.fi/sites/default/files/documents/eu-youth-strategy_en.pdf
2. Nxitja e bashkëpunimit midis të rinjve dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes objektivave të përbashkëta dhe iniciativave që i shërbejnë interesit të shoqërisë.
3. Mbështetja financiare do prioritizohet për projekte të udhëhequra nga të rinjtë marginalizuar, me aftësi të kufizuara, vajza dhe gratë e reja, komunitetet jo-shumicë, LGBTQ+-ja, të rinjtë në zona rurale, etj.
4. Mbështetja financiare do prioritizohet për mërgatën nëpërmjet projekteve të udhëhequra nga individë dhe grupe joformale të rinj nga mërgata dhe/ose projekteve që targetojnë të rinjtë e mërgatës.

Kush mund të aplikojë:

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës, grupet joformale, apo pjesëtarë të diasporës kosovare. Duhet të jenë qytetarë aktiv në shoqëri, me rrjet të gjerë të të rinjve, me përvojë të dëshmuar në menaxhimin apo pjesëmarrjen në projekte, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT DHE GRUPET JOFORMALE (të përfaqësuar nga një individ), të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se i riu është pjesëtar i diasporës, duhet po ashtu të ketë dhe vërtetoj shtetësinë e Republikës së Kosovës;
- Në rast që individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike të krijuara (mos të ketë avanse të hapura);
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT DHE GRUPET JOFORMALE të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzojnë projekt propozim të ndërlidhur me së paku njërin prej 11 Objektivave Evropiane për Rininë (European Youth Goals);

- Të japin informacion të mjaftueshëm se si aktivitetet e projektit të propozuar i shërbejnë adresimit të objektivave dhe komunitetit;
- Prioritet do kenë projektet me impakt të gjerë në të gjithë vendin dhe me impakte/produkte finale konkrete (psh. aplikacion/webfaqe, instalacion arti, video-dokumentar, publikim, etj.);
- Të listojnë numrin e të rinjve që do mobilizohen në kuadër të projektit;
- Të ketë së paku një partner lokal të përfshirë në implementimin e projektit të cekur në projekt-propozim, si: një ekspert, OJQ, qendër lokale (bibliotekë, teatër, qendër mjekësore, etj.), institucion arsimor apo biznes të regjistruar.
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve pozitive (apolitike) për komunitetin lokal dhe shoqërinë e gjerë gjatë 2 viteve të fundit ku kanë marrë pjesë si udhëheqës, staf, vullnetar apo pjesëmarrës;
- Të jetë student/e i regjistruar në universitet apo i/e sapo-diplomuar (2 vitet e fundit).
- Nëse nuk është i/e regjistruar në universitet apo nuk ka diplomuar, duhet të jetë profesionist i ri me së paku tre vite përvojë pune e cila dëshmohet me CV;
- Të ketë llogari bankare të hapur në Republikën e Kosovës;
- Të integrojnë komponentën e gjithë përfshirjes dhe rritjes së shkallës së integrimit social dhe ekonomik të të rinjve në rrezik marginalizimi si: të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe delikuentë, vajzat dhe gratë e reja, komunitetet joshumicë, komuniteti LGBTQ+, të rinjtë e zonave rurale, etj.
- Të jetë i moshës deri 18 - 24 vjeç.

Vini re:

Nëse projekti përzgjidhet dhe financohet nga MKRS, për qëllime të monitorimit është i obligueshëm informimi i Departamentit të Rinisë mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit së paku dy javë para realizimit të aktivitetit.

Nëse projekti përzgjedhet dhe financohet nga MKRS, organizata dhe vullnetarët e organizatës në zbatimin e projektit në kuadër të kësaj thirrjeje të regjistronen në platformën për certifikimin e orëve vullnetare 'Kosovo Volunteers' apo KoVo.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2023.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit 5,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit 3,000.00 Euro

Vlera totale e planifikuar për këtë kategori është 75,000.00 euro.